

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**SHOQERIA " FLEX CO SHPK "**

Në Lezhë, sot më 07.10.2024 u themelua shoqeri **FLEX CO SHPK**

**THEMELUESI:**

1. **Shoqeria H2 HOLDING L.L.C.** me NUI – 810038895 me adrese M 25-2 Veternik, Prishtine, Kosove me administrator z. Kujtim Hajredini me ID-1171426207.

Themelojme sipas kërkesave të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 date 14.04.2008, dhe ligjin nr 9723 date 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Biznesit " , si me poshtë:

**NENI 1**

Te krijoj shoqërinë tregtare me formë ligjore "Shoqeri me Përgjegjësi të Kufizuar" me emrin **FLEX CO** e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, dispozitat e kësaj kontrate, me statutin bashkëngjitur kësaj kontrate, me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008 dhe formalitetet që duhen plotësuar në të.

**NENI 2**

Selia e Shoqërisë **FLEX CO** " do të jetë në adresën: Lezhe, Shengjin, Ishull-Shengjin, zona kadastrale 1987, pasurine nr.40/163+1-59/3

**NENI 3**

Shoqëria do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e aktivitetit në : Import, eksport, tregtim, servisim të të gjithë llojeve të automjeteve si dhe mjeteve tjera të transportit. Import, export, tregtim i pajimeve të stacioneve të karikimit të makinave elektrike. Dhenia me qira e veturave. Shërbime në fushën e transportit të udhëtareve. Shërbime taksit për publikun si brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj. Zhvillimi i softuereve dhe aplikacioneve mobile. Perpunimi i të dhenave, hostimi i informacionit dhe aktivitetet e lidhura me to. Kompania mund të ushtroje çfaredo veprimtarie në territorin e Republikës së Shqipërisë që e lejon ligji.

**NENI 4**

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, vendqëndrimin, selinë, kohëzgjatjen, pjesëmarrjen e kuotave, objektin e veprimtarisë së saj, me vendim të ortakeve sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**NENI 5**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë: **10,000,000 (dhjete milion) leke** e përbërë nga 1 (nje) kuota që i perkasin ortakeve si me poshtë.

1. - Shoqeria H2 HOLDING L.L.C. me 100 % të kapitalit = 1 kuota = 10,000,000 leke

Çdo kuota i takon e drejta e një vote.

## NENI 6

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marrin ortakët, por në asnjë rast njeri ortak nuk mund të detyrojë ortakët e tjerë të rrisin kuotën e tyre në kapitalin e shoqërisë.

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të vërtetuara në dokumentet financiare, rezulton me i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortakët vendosin brenda tre muajve nga miratimi i llogarive të përcaktojnë këtë humbje mbi mundësinë e prishjes së parakohshme të shoqërisë. Në rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

## NENI 7

Ortaku që ka ndërmend t'u shesë të tretëve kuota të kapitalit të tij, tërësisht apo pjesërisht, duhet të njoftojë me pare ortakët e tjerë të shoqërisë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes qofte dhe në kushte të barabarta. Kjo e drejtë duhet ushtruar brenda 30 ditëve nga data e komunikimit. Për hollësi të mëtejshme ortakët do të referohen dispozitave të parashikuara në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 date 14.04.2008.

## NENI 8

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakeve;
- Administratori

Procedura për emërimin në funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit të shoqërisë.

## NENI 9

Administrator emerohet z. Kujtim Hajredini me ID-1171426207 me atësi Muharrem, amesi Fatime i datelindjes 23.03.1985, lindur dhe banues në Ulpiana U3 H4 Nr.2, Prishtinë, Kosovë .

Administratori zgjidhet për një afat 5 (pese) vjeçar me të drejtë ripërtëritjeje.

## NENI 10

Vendimet e Asamblesë janë të vlefshme nëse janë miratuar nga ortakët e saj sipas dispozitave të Ligjit Për Shoqëritë Tregtare në lidhje me pjesëmarrjen dhe shumicën e votave sipas kuotave në kapitalin themeltar për Asamblesë të Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme. Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme, kompetencave të ortakeve dhe marrjes së vendimeve do të bazohet në statutin e shoqërisë si dhe në Ligjin "Për shoqëritë tregtare".

## NENI 11

Likuiditet dhe transaksionet financiare do të depozitohen në bankat shqiptare dhe në ato të huaja, ku shoqëria ka llogarite e saj rrjedhëse.

Për kapitalin themeltar të shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do të shënohet kontributi i ortakut të vetëm. Po kështu shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit për kontabilitetin si dhe gjithë kërkesave të tjera financiare, të domosdoshme për veprimtarinë normale të saj.

## NENI 12

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria do të ndahet ndërmjet ortakut mbasi të jete likuiduar të gjitha detyrimet, dhe të jete hequr 5% që do të futet në fondin e rezervës ligjore deri në përmbushjen e 1/10 të kapitalit të shoqërisë.

### **ENI 13**

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në dy dokumente origjinale me fuqi të barabartë secila.

### **ORTAK I VETEM I SHOQERISE**

Shoqëria H2 HOLDING L.L.C.

Administrator Kujtim Hajredini

